



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njesia Org.
Org. Jedinica
Org Unit 01

Nr. Prot:
Broj Prot:
Prot. No. 05-1106

Nr. i faqeve
Br. stranica
No. pages - 05 -

Data:
Datum: 11/03/2019

Prishtinë / a



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

QENDRA KOSOVARE PËR REHABILITIMIN E
TË MBIJETUARVE TË TORTURËS
THE KOSOVA REHABILITATION CENTRE
FOR TORTURE VICTIMS

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT
PËR BASHKËPUNIM DHE QASJE NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË
NJËSIVE SHËNDETËSORE TË BURGJEVE**

NË MES TË

**DEPARTAMENTIT SHËNDETËSOR TË BURGJEVE (DSHB), MINISTRIA E
SHËNDETËSISË**

DHE

**QENDRËS KOSOVARE PËR REHABILITIMIN E TË MBIJETUARVE TË TORTURËS
(QKRMT)**

Në mbështetje të nenit 35 të Ligjit për Shëndetësi nr. 04/L-125, Udhëzimit Administrativ QRK Nr. 05/2014 për Funksonimin e Shërbimit Shëndetësor të Burgjeve nenit 14, paragrafi 5, dhe Statutit të Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Ministria e Shëndetësisë- Departamentit Shëndetësor i Burgjeve (në tekstin e mëtejme MSH- DSHB) dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (në tekstin e mëtejme QKRMT) lidhin këtë Marrëveshje.

Neni 1 Qëllimi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së bashkëpunimit ndërmjet QKRMT dhe MSH-DSHB (më tej palët nënshkruese), me qëllim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e vendosur në institucionet korrektuese të Kosovës.

Neni 2 Fusha e Zbatimit

MSH-DSHB në kuadër të bashkëpunimit do t'i ofroj QKRMT-së mbështetje për qasjen e ekipeve monitoruese të QKRMT në Njësitë Shëndetësore të Burgjeve (NjSHB) , në pajtueshmëri me fushëveprimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës - MKPT i Institucionit të Avokatit të Popullit - IAP , Memorandumin e Bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë për qasje në Institucionet korrektuese të Kosovës si dhe me standardet ndërkombëtare dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Të drejtat dhe detyrimet e QKRMT

1. Bashkëpunimi profesional me Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e vendosur në institucionet korrektuese të Kosovës.
2. Qasja e ekipeve monitoruese të QKRMT-se në Njësitë Shëndetësore të Burgjeve.
3. Ekipi Monitorues i QKRMT ka të drejtë të kontaktoj stafin shëndetësor të NjShB-ve dhe personat e dënuar apo të paraburgosur, në pajtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë fushë si dhe MM aktuale në mes të MD dhe QKRMT.
4. Për qasjen, obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të QKRMT-së, gjatë vizitave zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi, rendi shtëpiak i Institucioneve Korrektuese dhe Praktika Standarde e Veprimit të DShB-së.

5. Ekipi monitorues të QKRMT-së iu lejohet qasja në NjShB, duke përfshirë takimet me të dënuar-pacientë dhe konsultimin e dosjeve shëndetësore për qëllime të monitorimit për personat e privuar nga liria të vendosur në këto institucione sipas standardeve të aprovuara.
6. Ekipi monitorues i QKRMT-së është i obliguar që për çdo vizitë në NjShB, të informojnë me kohë Drejtorin e Departamentit Shëndetësor të Burgjeve apo të autorizuarin e tij/saj së paku 24 orë para vizitës.
7. Ekipi monitorues i QKRMT-së është i obliguar që të takohet më Udhëheqësin e NjShB përkatëse para dhe pas vizitës dhe në rast nevojë edhe me Drejtorin e DShB.
8. Pasqyrimi në mënyrë objektive, bazuar në Standardet e aprovuara, i gjendjes dhe të gjeturave eventuale në NjShB.
9. Bashkëpunimi mbi bazën e kërkesave të identifikuar gjatë vizitave monitoruese dhe rasteve të tjera të identifikuar. Bashkëpunimi realizohet dhe udhëhiqet në bazë të parimeve të ligjshmërisë, paanësisë, konfidencialitetit mjekësor dhe profesionalizmit dhe merr përgjegjësinë për ruajtjen, publikimin eventual dhe respektimin e tyre.
10. Në raport me ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave gjatë monitorimit dhe trajtimit të rasteve, anëtarët e QKRMT janë të obliguar t'i zbatojnë rregullat e brendshme të QKRMT-së të përcaktuara për këtë qëllim.
11. QKRMT është e obliguar që me kohë dhe para publikimit të dërgoj draft raportet për shqyrtim dhe komentim eventual nga ana e DShB-së në funksion të arritjes së pajtueshmërisë dhe transparencës aq sa është e mundur.
12. Gjatë monitorimit të procesit lidhur me zbatimin e Praktikave Standarde të Veprimit për shërbimet shëndetësore të cilat i kryen DShB si dhe raportimin e gjetjeve, palët nënshkruese duhet t'u përmbahen standardeve të garantuara me traktate ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në parimet e vendosura me aktet dhe mekanizmat relevant ndërkombëtar dhe vendor në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.
13. Ekipi monitorues i QKRMT, me rastin e vizitave në NjShB, duhet të mbajë të ekspozuar kartelën identifikuese.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e DShB**

1. Të lejohet qasje e ekipit monitorues të QKRMT-së në të gjitha hapësirat e NjShB-ve dhe dokumentacionin tjetër relevant të punës si dhe rregulloret e brendshme të punës së DShB.
2. Të lejohet qasje e ekipit monitorues të QKRMT-së qasja në dosjen mjekësor të të burgosurve në NjShB në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe normave etike morale e konfidenciale mjekësore.